

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

PESHKIM

Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor “DETARI”)

Kodi: J1-III-23

Miratoi:

MINISTRI

.....

TIRANË, 2023

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit “Detari”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK të drejtimit “Detari”.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK
- III. Plani mësimor për profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK , të drejtimit “Detari”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK (i vjeçar), të drejtimit “Detari”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me peshkimin”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK , të drejtimit “Detari”.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Peshkim”, niv. III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Peshkim” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Detari”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efëçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Peshkim”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Peshkim”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale të sektorit të peshkimit;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të sektorit të peshkimit;
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në proceset e përgatitjes teknike për lundrimin e anijes për qëllime peshkimi;
- Të kryejë shërbime të mirëmbajtjes të thjeshta në kuvertë dhe makineri;
- Të punojë në grup në procesin e riparim-dokimit të mjetit lundrues;
- Të kryejë shërbime të thjeshta mirëmbajtje të teknikës së gjuetisë në kushte toke;
- Të interpretojë strukturën e ndërtimit të disa veglave të gjuetisë;
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin bazë të mjetit të peshkimit;
- Të kryejë detyrat e shërbimit në urën e komandës në lundrim, qëndrim në spirancë dhe gjatë gjuetisë;
- Të vlerësojë sasinë e rezervave lundrimore në hidrokarbure, ushqim, ujë etj. për numrin e ekuipazhit dhe kohëzgjatjen e mundshme të lundrimit;
- Të realizojë shtrimin grafik të lundrimit të supozuar në hartë;
- Të përcaktojë vendodhjen e anijes me objekte bregdetare;
- Të kryejë veprimet për përgatitje, hedhje dhe ngritje të spirancës sipas urdhrave të dhënë;
- Të realizojë kalimin nga drejtimi me dorë në autopilot dhe anasjelltas;
- Të përshkruajë veçoritë e fenerëve detar;
- Të komunikojë me radio sipas standardeve të sistemit të global detar të rrezikut (GMDSS);
- Të përdorë pajisjet radionavigacionale për qëllime të lundrimit të sigurtë dhe të gjuetisë;
- Të përshkruajë përdorimin e pajisjeve të raportimit automatik satelitor të situatave të emergjencës EPIRB dhe SART;
- Të kryejë detyrat e shërbimit dhe punimet ndihmëse elektromekanike në lokalin e makinerisë;

- Të interpretojë gjendjen e tankeve dhe transferojë mbetjeve hidrokarbure tek impiantet e grumbullimit portual;
- Të punojë në grup për kryerjen sa më të rregullt të procesit të gjuetisë me disa mënyra;
- Të kryejë riparime të thjeshta të veglave të gjuetisë të dëmtuara nga gjuetia në anije;
- Të kryejë procedura të përpunimit paraprak të peshkut në anije;
- Të zbatojë standartet e sigurisë, shëndetit dhe mjedisit në punë në anije gjatë lundrimit, gjuetisë, punës në temperatura mjaft të ulta;
- Të përshkruajë veçoritë kimike të ujrave;
- Të përshkruajë sëmundjet dhe shenjat kryesore të peshqve;
- Të përshkruajë kriteret kryesore ligjore që lidhen me gjuetinë detare;
- Të rendisë rregullat e FAO-s në lidhje me ruajtjen e ekuilibrave botërore gjueti – ruajtje rezervash peshkore për peshkun ton;
- Të komunikojë me etikë profesionale;
- Të përdorë mjete dixhitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Peshkim”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III në KSHK, e pajis individin me Certifikatën profesionale të këtij niveli dhe suplementin përkatës, si dhe me një përvojë pune në det me anijet dhe sektorin përkatës, jo më pak se gjashtë (6) muaj. Individit i lind e drejta të testohet dhe kualifikohet nga Administrata Detare si Peshkatar i Kualifikuar, Kapitulli IV/1 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW-’95, dhe/ose Marinar Kuverte në kualifikimin II/4, dhe/ose Mekanik Shërbimi në kualifikimin III/4 sipas Konventës të STCW’78 e ndryshuar, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, me ato shtete që vendi ynë ka marrëveshje.

Me përfundimin e kualifikimit në këtë nivel, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Detari”, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare ose pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.

Plani mësimor për profilin mësimor “Peshkim”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2

6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	8 (272)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-30-607-23	Mirëmbajtja e mjetit të lundrimit dhe teknikës së gjuetisë	1
3	L-30-447-23	Lundrim	1
4	L-30-608-23	Pajisje radionavigacionale GMDSS	1
5	L-16-055-23	Teknologji peshku	2
6	L-24-418-23	Elektromekanika në anije	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-30-1882-23	Mirëmbajtja e mjetit lundrues dhe teknikës së gjuetisë	33
2	M-16-1285-23	Lundrim	87
3	M-30-1883-23	Përdorimi i pajisjeve radionavigacionale GMDSS	33
4	M-16-1286-23	Gjuetia e peshkut në det	135
5	M-16-1365-17	Përpunimi paraprak i peshkut	33
6	M-24-1287-23	Punime ndihmëse elektromekanike në sektorin e makinerisë së anijes	87
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	2 (68)
1	M-16-1366-23	Punime mirëmbajtëse në anijen e peshkimit mbi ujë	68
2	M-16-1367-23	Punime mirëmbajtëse në anijen e peshkimit në dok	68
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që

të nxësin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Peshkim”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Peshkim”.

Instruktori i praktikës profesionale duhet të udhëhiqet nga kërkesat e legjislacionit, Udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe në parimet e praktikës së sigurtë të punës në det. Për këtë, duhet ti referohet citimeve përkatëse të legjislacionit si vijon:

Ligji Nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”

Neni 101

Nxënësit dhe praktikantët

1. Kapitani mund të pranojë në mjetin lundrues, me leje të pronarit dhe me miratimin e kapitanerisë së portit ku ka qendrën, nxënës të shkollave detare dhe praktikantë të profesioneve detare, të cilët mund të kryejnë detyra vetëm në prani të anëtarit të ekuipazhit që ka dëshminë përkatëse.
2. Në mjetet lundruese të transportit të udhëtarëve, nxënësit dhe praktikantët mund të jenë vetëm vëzhgues të veprimeve.
3. Nxënësit ose praktikantët, që janë në mjetin lundrues gjatë lundrimit, konsiderohen pjesëtarë të ekuipazhit, me dallimet përkatëse në paga.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Peshkim”, niveli

III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e detarisë dhe peshkimit, dhe u jepet çertifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

Në përputhje me Ligjin Nr. 10109 datë 10.2.2009 “Për Administratën Detare në Republikën e Shqipërisë”, Shkolla profesionale duhet të bashkërendojë veprimtaritë përkatëse praktike dhe të testimi me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për procesin e kualifikimit të nxënësve të drejtimit mësimor “Peshkim”, niveli III i KSHK.

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Peshkim”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale të këtij niveli dhe suplementin përkatës. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale, modulet profesionale dhe praktikën profesionale të grupuar, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK;

Me një përvoje pune praktike në det jo më pak se gjashtë (6) muaj, në sektorin përkatës, nxënësi përfiton nga Administrata Detare edhe Certifikatën e kualifikimit si Peshkatar i Kualifikuar (Kapitulli IV/1 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW-’95ⁱ) dhe/ose Marinar Kuverte në kualifikimin II/4 të STCW’78ⁱⁱ e ndryshuar (Ligji Nr. 8569 datë 20.01.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare” dhe “Për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët” (STCW 1978 e amenduar), të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nga IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare).

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë

Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë

2. Lënda “Mirëmbajtja e mjetit të lundrimit dhe teknikës së gjuetisë” (L-30-607-23). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës “Mirëmbajtja e mjetit të lundrimit dhe teknikës së gjuetisë”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mirëmbajtja e mjetit të lundrimit dhe teknikës së gjuetisë”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë hapat e punës për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe agregateve në funksion të akostim/ç’akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë mënyrat e sistemimit të sigurt dhe të rregullt të cimave pas akostimit;
- Të përshkruajë përdorimin e gomave mbrojtëse në funksion të akostim/ç’akostimit dhe qëndimit në kalatë pa i shkaktuar dëme mjetit lundrues;
- Të përshkruajë vendet dhe mënyrat e vendosjes së mbrojtësve ndaj brejtësve;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gatishmërisë së mjeteve dhe veglave të punës për punime mirëmbajtëse në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e instruktimit paraprak për përdorimin e mjeteve, veglave dhe planit të punës për mirëmbajtje në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mbikëqyrjes së zbatimit të planit të punës për mirëmbajtje në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e bashkërendimit të zbatimit të planit të mirëmbajtjes me aktivitete të tjera që ndërthuren në sektorin e kuvertës;
- Të përshkruajë rregullat dhe praktikat për përgatitjen e bojërave për lyrje;

- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve të takilazhit, të shpëtimit, MNZ, etj.;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve të lëvizshme në mbistrukturë;
- Të përshkruajë rëndësinë, praktikat dhe hapat e punës për kryerjen e punimeve në hapësira të mbyllura;
- Të përshkruajë rëndësinë, praktikat dhe hapat e punës për kryerjen e punimeve jashtë bordit ose në lartësi;
- Të përshkruajë praktikat dhe hapat e punës për kryerjen e punimeve mirëmbajtëse dhe riparuese në akomodim;
- Të përshkruajë funksionimin e organizimit për gatim dhe ruajtjen e rezervave ushqimore në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë materialet e përdorshme dhe funksionet e tyre në mjetin lundrues për peshkim;
- Të përshkruajë llojet, veglat dhe hapat e punës për kryerjen e riparimeve të thjeshta të veglave të peshkimit përfshirë në kushtet e anijes;
- Të përshkruajë shërbimet për jetëgjatësinë e materialeve dhe veglave të peshkimit në kushtet e anijes;
- Të përshkruajë bazat teorike të ndërtimit dhe funksionimit të tratës së kështit tradicionale;
- Të përshkruajë bazat teorike të ndërtimit dhe funksionimit të tratës binjake (pellagjike mesujore);
- Të përshkruajë bazat teorike të ndërtimit dhe funksionimit të tratës së kështit tip francez;
- Të përshkruajë bazat teorike të ndërtimit dhe funksionimit të tratës së kështit tip amerikan;
- Të përshkruajë bazat teorike të ndërtimit dhe funksionimit të tratës së kështit tip italian;
- Të përshkruajë bazat teorike të ndërtimit dhe funksionimit të koshilokut për gjuetinë e peshkut ton;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat kryesore të mirëmbajtjes së agregateve në lokalit e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për mirëmbajtjen e daljeve të ajrimit nga lokale të ndryshme;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gatishmërisë së mjeteve dhe veglave të punës për punime mirëmbajtjeje në makineri;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e instruktimit paraprak për përdorimin e mjeteve të punës për mirëmbajtje në sektorin e makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë e mënyrat e mbikëqyrjes së zbatimit të planit të punës për mirëmbajtje në makineri;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e bashkërendimit të zbatimit të planit të mirëmbajtjes me aktivitete të tjera që ndërthuren në sektorin e makinerisë;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrën e llogaritjes së sasive të bojërave që do të aplikohen në karenë (skaf);
- Të përshkruajë hapat për kontrollin e gatishmërisë së veglave të punës për punimet e riparim-dokimit;
- Të përshkruajë hapat e punës për kapjen e cimave, vendosje fashosh ngritëse, raportim qendërzimi të mjetit etj. për daljen në dok të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës për pastrimin e pjesës së karenës (skafit) nga bimësia;
- Të përshkruajë gjendjen e karenës pas pastrimit nga bimësia;
- Të përshkruajë hapat e punës për marrjen e njollave me bojë antikorrozive në karenë;
- Të përshkruajë hapat e punës, mjetet dhe materialet për luçidimin dhe grasatimin e fletëve të elikës;

- Të përshkruajë hapat e punës për pastrimin e pikave në skaf ku do të kryhet matje e trashësisë së lamjerës;
- Të përshkruajë hapat e punës së sigurt për uljen e spirancës në tokë;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të imtësishëm të hallkave dhe gambetave lidhëse të gadinës së spirancës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të sigurimit të gambetës fundore në pusin e gadinës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të gambetës dhe xhokolinos që lidh gadinën me spirancën;
- Të përshkruajë mënyrën dhe mjetet për markimin e copëve (çelësave) të gadinës;
- Të përshkruajë mënyrën e futjes dhe stivimit në pus të gadinës;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të saldimit mbas heqjes së protektorëve të vjetër;
- Të përshkruajë hapat e punës për grasatimin e protektorëve të rinj para lyerjes së karenës;
- Të përshkruajë detyrat në raste të asistencës ndaj specialistit të zëvendësimit të majereve të dëmtuara në skaf ose në kuvertë;
- Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së stukos tek hapësirat mes majereve të zëvendësuara ose ku mungon;
- Të përshkruajë hapat e punës për çmontimin dhe montimin e valvolave, tubacioneve, saraçineskave, panjollave në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për çmontimin dhe montimin e kapakëve të depove/tankeve të ndryshme;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe praktikën për gatishmërinë e mjeteve të MNZ kur kryhen saldime, zëvendësohen lamiera metalike etj.;
- Të përshkruajë rëndësia dhe praktikën e punës për lyerjen e karenës me bojën antikorrozive dhe antivegetative;
- Të përshkruajë hapat e punës për uljen në ujë të mjetit lundrues mbas dokimit;
- Të përshkruajë hapat e punës për kapjen e cimave, vendosje fashosh ngritëse, raportim qendërzimi të mjetit etj. për uljen nga doku të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe praktikën e punës për matjen, raportimin e gjendjes së tankeve apo futjes së ujit nga bokola e “stella-morte-s”, “preso di mare”, etj. mbas uljes në ujë të mjetit lundrues;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mirëmbajtje e mjetit lundrues dhe teknikës së gjuetisë”, kl. 12 - 34 orë:**

Tema 1	Mirëmbajtja e kuvertës	2 orë
Tema 2	Mirëmbajtja e veglave dhe paisjeve të omërgjimit	2 orë
Tema 3	Mirëmbajtja e paisjeve të shpëtimit të jetës dhe të luftës ndaj zjarrit	4 orë
Tema 4	Punimet e veçanta (hapësira të mbyllura, jashtë bordit, etj.)	4 orë
Tema 5	Mirëmbajtja e hotelit dhe prapavija	4 orë
Tema 6	Ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e veglave të gjuetisë	8 orë
Tema 7	Mirëmbajtja në lokalin e makinerisë	6 orë
Tema 8	Riparim-dokimi	4 orë

3. Lënda “Lundrim” (L-30-447-23). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës “Lundrim”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Lundrim”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të dallojë formën dhe lëvizjen e tokës, pikat dhe rathët kryesore, koordinatat gjeografike në funksion të lundrimit;
- Të përshkruajë veçoritë e magnetizmit tokësor, busullën magnetike, ndikimi i saj mbi anije;
- Të përshkruajë mënyrën e korigjimit dhe kthimit të kurseve dhe pelengjeve;
- Të shpjegojë madhësitë gjatësore për matjen e largësive dhe thellësive në lundrim, si dhe aparatet matëse të tyre;
- Të përshkruajë projeksionet hartografike, shkallën e hartave, leximin e tyre, shtrimin grafik të lundrimit në hartë;
- Të përshkruajë metodat e përcaktimit të vendodhjes së anijes me objekte bregdetare;
- Të përshkruajë ndikimin e erërave dhe rrymës detare mbi mjetin lundrues;
- Të listojë literaturën lundrimore në funksion të gjuetisë dhe lundrimit;
- Të vlerësojë kushtet atmosferike, lundrimore, batimetrike, gjeografike, etj. në funksion të planit të gjuetisë;
- Të përshkruajë liçensat dhe dokumentacionin e anijes së peshkimit para lundrimit për gjueti peshku;
- Të përshkruajë veçoritë e lundrimit të anijes në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj.;
- Të përshkruajë veçoritë e një feneri të caktuar detar nga karakteristikat e tij;
- Të përshkruajë funksionet e treguesve të ndryshëm në urën e komandës;
- Të interpretojë sinjalistikën sipas REPAD-it në një mjet lundrimi për peshkim;
- Të vlerësojë sasinë e rezervave lundrimore në hidrokarbure, ushqim, ujë etj. për numrin e ekuipazhit dhe kohëzgjatjen e mundshme të lundrimit;
- Të përshkruajë masat për shmangien e tejlodhjes dhe pasojat në këto raste;
- Të përshkruajë sistemet dhe praktikat e komunikimit të brendshëm në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë sistemin e ndriçimit të brendshëm në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë funksionimin e organizimit për gatim në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë detyrat e shërbimit në marrje, dorëzim dhe gjatë tij në urën e komandës;
- Të argumentojë rëndësinë e vrojtimit, raportimit në kohë dhe qartë në shërbim në urën e komandës;
- Të përshkruajë hapat e punës për kalimin e drejtimit në lundrim nga busulla magnetike në autopilot dhe anasjelltas;
- Të listojë urdhrat në timon në terminologjinë shqipe dhe angleze;
- Të listojë terminologjinë e përdorshme në sektorin e kuvertës dhe të makinerisë në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë hapat e punës për përdorimin e pajisjeve dhe agregateve në funksion të akostim/ç’akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë dinamikën e lëvizjes së mjetit lundrues për akostim/ ç’akostim;
- Të argumentojë sigurinë e punës gjatë akostim/ç’akostimit të mjetit lundrues;
- Të interpretojë leximet e telegrafës;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mekanizmit të hedhjes/marrjes së spirancës;
- Të interpretojë shenjëzimin e ndarjes së gjatësive të gadinave të spirancës;
- Të përshkruajë simbolet, dritat dhe vendet e shfaqjes sipas REPAD, gjatë qëndrimit në spirancë;
- Të përshkruajë masat për sigurimin e mekanizmit të spirancës pas hedhjes/marrjes në/nga uji;
- Të përshkruajë praktikën e punës për raportim të drejtimit të gadinës kur spiranca hidhet apo merret nga uji;

- Të përshkruajë detyrat gjatë marrjes së gadinës në mjetin e lundrimit;
- Të përshkruajë detyrat në shërbim në urën e komandës ose në lokalin e makinerisë kur mjeti lundruet ndodhet në spirancë;
- Të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe mënyrat e përdorshme për rimorkimin e mjetit lundruet;
- Të përshkruajë detyrat e ekuipazhit para, gjatë dhe mbas rimorkimit;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Lundrim”, kl. 12 - 34 orë:**

Tema 1	Forma dhe lëvizja e tokës, pikat dhe rrathët kryesore, koordinatat gjeografike në funksion të lundrimit	2 orë
Tema 2	Magnetizmi tokësor, busulla magnetike dhe ndikimi i saj mbi anije	3 orë
Tema 3	Korigjimi dhe kthimi i kurseve dhe pelengjeve	2 orë
Tema 4	Madhësitë e ndryshme gjatësore që përdoren për matjen e largësive dhe thellësive në lundrim, si dhe aparatet matëse të tyre	2 orë
Tema 5	Projeksionet hartografike, shkalla e hartave, leximi i tyre, shtrimi grafik i lundrimit në hartë	2 orë
Tema 6	Përcaktimi i vendodhjes së anijes me objekte bregdetare	3 orë
Tema 7	Erërat dhe rrymat detare dhe ndikimi i tyre tek anija në lundrim	2 orë
Tema 8	Veçoritë e lundrimit në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj.	2 orë
Tema 9	Fenerët detar, funksioni dhe karakteristikat;	2 orë
Tema 10	Literatura navigacionale, ditari i lundrimit dhe dokumentacioni në funksion të aktivitetit të gjuetisë;	2 orë
Tema 11	Përgatitja për lundrim	3 orë
Tema 12	Detyra në lundrimin në kuvertë dhe makineri në funksion të gjuetisë	4 orë
Tema 13	Afrimi, qëndrimi dhe largimi nga spiranca e mjetit lundruet	2 orë
Tema 14	Rimorkimi	3 orë

4. Lënda “Pajisje radionavigacionale GMDSS” (L-30-608-23). Kl. 12 - 34 orë

• **Synimet e lëndës “Pajisje radionavigacionale GMDSS”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Pajisje radionavigacionale GMDSS”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të listojë llojet e paisjeve radio-navigacionale që instalohen në një mjet lundrimi për qëllime peshkimi;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të pajisjeve radio-navigacionale që instalohen në një mjet lundrimi peshkimi;
- Të interpretojë leximet e instrumenteve për parashikimin e motit;
- Të interpretojë sinjalet e alarmeve dhe rëndësinë e reagimit saktë dhe në kohë;
- Të argumentojë rëndësinë e shmangies së alarmeve të rreme dhe veprimet në rast të një aktivizimi aksidental;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Radarit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Xhirobusullës në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Autopilotit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e GPS-së në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Ehollotit në anije;

- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Sonarit në anijen e peshkimit;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Navtex-it në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Blue Box-it në anijen e peshkimit;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e AIS (sistemi i identifikimit automatik) në anije;
- Të përshkruajë treguesit e ndryshëm radionavigacional në urën e komandës dhe integrimi i tyre;
- Parimi i punës dhe funksionimi i EPIRB-it 406 MHz (Emergency Indicating Radio Beacon);
- Parimi i punës dhe funksionimi i SART-it (Search And Rescue Radar Transponder);
- Të përshkruajë parimet e përgjithshme dhe tiparet bazë të shërbimeve të komunikimit të lëvizshëm detar;
- Të përshkruajë parimet e punës të Sistemit Global të Komunikimit për Rreziqet dhe Sigurinë në Det;
- Të përshkruajë metodat e komunikimit detar, me autoritete, mjetete të tjera lundruese për raste sigurie, rreziqesh, raportimi, etj.;
- Të përshkruajë legjislacionin, rregullat dhe institucionet përkatëse për komunikimin në det.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pajisje radionavigacionale GMDSS”, kl.12- 34 orë**

Tema 1	Paisjet radio-navigacionale në mjetin e lundrimit për peshkim	1 orë
Tema 2	Sinjalet e alarmit	1 orë
Tema 3	Parimi i punës dhe funksioni i Radarit në anijen e peshkimit;	2 orë
Tema 4	Parimi i punës dhe funksioni i Xhirobusullës në anije;	2 orë
Tema 5	Parimi i punës dhe funksioni i Autopilotit në anije;	2 orë
Tema 6	Parimi i punës dhe funksioni i GPS-së në anije;	2 orë
Tema 7	Parimi i punës dhe funksioni i Eholotit-it në anijen e peshkimit;	2 orë
Tema 8	Parimi i punës dhe funksioni i Sonarit në anijen e peshkimit;	2 orë
Tema 9	Parimi i punës dhe funksioni i Navtex-it në anije;	2 orë
Tema 10	Parimi i punës dhe funksioni i Blue Box-it në anijen e peshkimit;	2 orë
Tema 11	Treguesit radionavigacional në urën e komandës dhe integrimi;	2 orë
Tema 12	Parimi i punës dhe funksionimi i EPIRB-it 406 MHz (Emergency Indicating Radio Beacon);	1 orë
Tema 13	Parimi i punës dhe funksionimi i SART-it (Search And Rescue Radar Transponder);	1 orë
Tema 14	Parimet e përgjithshme dhe tiparet bazë të shërbimeve të komunikimit të lëvizshëm detar (IMO Model 1.26);	4 orë
Tema 15	Parimet e punës të Sistemit Global të Komunikimit për Rreziqet dhe Sigurinë në Det GMDSS;	4 orë
Tema 16	Rregullat dhe legjislacionin përkatës të komunikimit në det.	4 orë

5. Lënda “Teknologji peshku” (L-16-055-23). Kl. 12 - 68 orë

• **Synimet e lëndës “Teknologji peshku”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji peshku”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë planin e gjuetisë të hedhur në hartë sipas koordinatave gjeografike;

- Të rendisë rregullat, metodat dhe pajisjet për vrojtimin e peshkut;
- Të interpretojë informacionin që paraqesin pajisjet për vrojtimin e peshkut;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mjeteve dhe veglave kryesore të punës të instaluar në një mjet lundrimi peshkimi;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mekanizmave të instaluar në kuvertë në një mjet lundrimi për peshkim;
- Të përshkruajë kriteret e gjuetisë me vegla pasive si kosh, gracka dhe kutia notuese;
- Të përshkruajë bazat teorike të ekuilibrit dhe organizimin e punës në gjuetinë me trata kiçi dhe tratat binjake;
- Të radhisë hapat për gjuetinë me grepa;
- Të përshkruajë parimet dhe rregullat për gjueti specifike;
- Të përshkruajë parimet dhe rregullat e gjuetisë sportive;
- Të shpjegojë procedurat e sigurta të punës për hedhjen/marrjen e veglës së gjuetisë;
- Të përshkruajë masat e sigurisë në punë, normat e higjenes, veprimet në kuvertë pas rihedhjes së veglës së gjuetisë në ujë për gjuetinë e radhës.
- Të përshkruajë vetitë fiziko kimike të ujërave;
- Të përshkruajë parimet dhe shtresat e përhapjes së dritës në ujëra;
- Të përshkruajë karakteristikat dhe veçoritë e organizmave ujorë;
- Të përshkruajë sëmundjet kryesore që evidentohen tek peshqit;
- Të përshkruajë shenjat e peshqve të sëmurë nga ato normale;
- Të listojë llojet dhe cilësitë kryesore të peshqve dhe produkteve të tjera detare më të zakonshme në ujërat e Mesdheut;
- Të përshkruajë llojet dhe veçoritë e ambalazheve për produktet nga gjuetia;
- Të përshkruajë mënyrën e seleksionimit dhe sistemit të peshkut mbas gjuetisë;
- Të përshkruajë hapat e punës të trajtimit paraprak për ruajtjen e freskisë së produkteve nga gjuetia deri në dorëzimin në stabilimentet në breg;
- Të përshkruajë normat dhe procedurat e punës për raportim të produkteve të zëna nga gjuetia nëpërmjet shënimeve në ditar, raportimin me radio dhe blue-boxit;
- Të përshkruajë procedurat e dorëzimit në stabilimentet në breg të produkteve të zëna nga gjuetia;
- Të përshkruajë treguesit kryesorë për referimin e çmimeve të tregut për lloje specimesh peshku dhe produkteve detare;
- Të përshkruajë treguesit kryesorë për referimin e klientëve potencialë për produktin e pritshëm nga gjuetia;
- Të përshkruajë treguesit kryesorë për referimin e çmimeve të tregut për veglat, materialet e gjuetisë, karburanteve, ambalazheve etj.
- Të llogarisë një bilanc të thjeshtë të kostove dhe të ardhurave nga gjuetia;
- Të përshkruajë kriteret kryesore ligjore që lidhen me gjuetinë detare;
- Të rendisë rregullat e FAO-s në lidhje me ruajtjen e ekuilibrave botërore gjueti – ruajtje rezervash peshkore për peshkun ton;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji peshku”, kl.12- 68 orë**

Tema 1	Përgatitja për hedhje të veglave për gjueti;	8 orë
Tema 2	Gjuetia me kosh, gracka, kutia notuese, trata kiçi, trata binjake, grepa, gjuetia specifike, gjuetia sportive, etj.;	12 orë
Tema 3	Masat paraprake të sigurisë në punë, higjenike dhe operacionale për pritjen e veglës së gjuetisë me produktin e mundshëm	6 orë
Tema 4	Vetitë fiziko-kimike, përhapja e dritës dhe organizmat ujorë;	6 orë
Tema 5	Llojet kryesore të peshqve në mesdhe dhe sëmundjet kryesore;	6 orë

Tema 6	Sistemimi dhe ruajtja e freskisë së produktit të zënë nga gjuetia;	6 orë
Tema 7	Raportimi dhe dorëzimi në breg;	6 orë
Tema 8	Vlerësimi i efiçencës së gjuetisë;	10 orë
Tema 9	Rregullat e FAO-s dhe kriteret ligjore të gjuetisë detare;	8 orë

6. Lënda “Elektromekanika në anije” (L-24-418-23). Kl. 12 - 34 orë

- **Synimet e lëndës “Elektromekanika në anije”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Elektromekanika në anije”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë detyrat e shërbimit në marrje, dorëzim dhe gjatë tij në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë masat për shmangien e tejlodhjes dhe pasojat në këto raste;
- Të argumentojë rëndësinë e vrojtimit, raportimit në kohë dhe qartë në shërbim në lokalin e makinerisë;
- Të interpretojë simbolet dhe markimet e aplikueshme në skema, sisteme, agregate dhe në vende të ndryshme në lokalin e makinerisë;
- Të interpretojë leximet e treguesve të presioneve, gazrave, temperaturave etj.
- Të listojë hapat dhe mjetet e nevojshme për matjen e tankeve;
- Të përshkruajë hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e agregateve të instaluar si pompa elektrike dhe/ose pompa hidraulike në funksion të shërbimeve në det;
- Të përshkruajë sistemin e drejtimit përfshirë reagimin në raste avarie;
- Të përshkruajë hapat dhe mjetet e punës për zmontimin, zëvendësimin, riparimin dhe montimin e tubacioneve, valvolave dhe saraçineskave të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat e punës për zmontimin dhe montimin e kapakëve të depove/tankeve të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat e punës për eliminimin e rrjedhjeve nga tubacionet në anije;
- Të përshkruajë hapat e punës për zmontimin dhe montimin e panjollave në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për marjen e masave për furnizimin me karburant dhe ujë;
- Të argumentojë rëndësia dhe mënyrat e sigurimit dhe kontrollit të sigurimit të pjesëve të këmbimit dhe furnizimeve në depo;
- Të përshkruajë parimet dhe hapat e punës së sigurt me sistemet elektrike, pneumatike, hidraulike, etj. në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës së sigurt për takim/s’takimin e energjisë për agregate të ndryshme nga lokali i makinerisë;
- Të përshkruajë detyrat për mosndotjen e mjedisit detar në shërbim në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për thithjen dhe nxjerrjen jashtë tek impiantet marrëse portuale të mbeturinave hidro-karbure në anije si sentina, llumra nga separatori, vaji i djegur, etj.
- Të argumentojë rëndësinë e mbledhjes së mbetjeve hidrokarbure në lokalin e makinerisë dhe të dorëzimit të tyre në impiantet pritëse portuale;
- Të përshkruajë masat për hermetizimin e lokalit të makinerisë në raste emergjencash;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe praktikat e aplikueshme për shmangien e ndotjes jashtë bordit nga lokali i makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë e njohjes dhe zbatimit të procedurave të punës, mjeteve, kushteve, individëve pjesëmarrës, reagimin në rast avarie etj., kur i caktohet një detyrë e re nga eprori;
- Të përshkruajë masat e sigurisë për punime saldimi në lokalin e makinerisë;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektromekanika në anije”, kl.12 - 34 orë**

Tema 1	Shërbimi në lokalin e makinerisë. Tejlodhja.	4 orë
Tema 2	Simbolet, markimet, treguesit e punës së agregateve	3 orë
Tema 3	Motorri kryesor dhe ndihmuesat;	6 orë
Tema 4	Sistemi i drejtimit	2 orë
Tema 5	Paneli i energjisë. Agregatet elektrike dhe hidraulike të instaluar.	5 orë
Tema 6	Kompresorët e ajrit. Funkzioni, mirëmbajtja dhe puna me to.	2 orë
Tema 7	Sistemet e tubacioneve. Valvolat dhe saraçineskat në anije.	2 orë
Tema 8	Tanket, depot dhe sentinat.	2 orë
Tema 9	Furnizimi me karburant, vaj lubrifikant dhe ujë;	2 orë
Tema 10	Mbetjet hidrokarbure. Dorëzimi në impantet pritëse portuale.	2 orë
Tema 11	Masat për parandalimin dhe reagimin ndaj ndotjes;	2 orë
Tema 12	Masat e sigurisë për kryerjen e punimeve speciale dhe të saldimit.	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Mirëmbajtje e mjetit lundrues dhe teknikës së gjuetisë”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MIRËMBAJTJE E MJETIT LUNDRUES DHE TEKNIKËS SË GJUEISË	M-30-1882-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në mirëmbajtjen e mjetit lundrues dhe të teknikës së gjuetisë në kushtet e qëndrimit në port.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen shërbimin në kuvertë/lokalin e makinerisë gjatë qëndrimit në port. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të jetë i gatshëm nga aspekti shëndetsor, mendor, (të ketë pushuar mjaftueshëm për të qëndruar aktiv gjatë shërbimit);- të sigurohet që nevojat për ushqim, komunikim, që ka akses në lokalet kritike të mjetit lundrues;- të marrë informacionet nga Kapiteni/Kryemekaniku që lidhen me specifika në kuvertë, makineri, sigurinë e mjetit lundrues, lista kontakti për raste emergjence, etj.;- të mbajë veshur veshjet e sigurisë në punë;- të kryejë larjen e kuvertës dhe pastrimin makinerisë për mbetje nga gjuetia, sipërfaqe të rrëshkitshme, prezencë vajore, etj. duke përdorur solucionet përkatëse dhe shmangur ndotjen në mjedis;- kryen sistemime të objekteve të mbetura në kuvertë si, cima të tepërta, kavo, ambalazhe, vegla pune, bojra, etj.;- kontrollon sigurimin e vinçit të spirancës, vinçit të tratës, tratës në platformën e qëndrimit, tajat, gambetat, timonët e

- tratës, etj.;
- të kontrollë periodikisht tendosjen dhe sigurinë e cimave të akostimit, në bash, në kiç dhe springjet, përfshirë pozicionimin e duhur të gomave mbrojtëse dhe të mbrojtësve ndaj brejtësve;
 - të përdorë sipas nevojës sistemin e ndriçimit gjatë kontrolleve apo kryerjes së detyrave të lëna;
 - kontrollon dhe cekon sipas nevojës sentinat e makinerisë duke i transferuar tek tanku i mbledhjeve;
 - të kontrollojë vijën e galeximit herë pas here dhe njoftojë me urgjencë në rast ndryshimi të saj apo të animit të mjetit lundrues;
 - të ndezë gjeneratorin ndihmues dhe pompat zjarrfikëse në raste emergjence;
 - të njoftojë menjëherë në rast konstatimi të tymit, ujit, zjarrit, të panjohurve, etj. në bord;
 - të jetë vigjilent dhe i kujdesshëm gjatë kryerjes së shërbimit;
 - të raportojë në kohën e duhur tek Kapitenit/Kryemekanikut për konstatimet;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
 - të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi kryen shërbime mirëmbajtëse në teknikën e gjuetisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të mbajë veshur mjetet e sigurisë në punë;
- të marrë informacionet e përgjithshme dhe hapat e punës nga Kapiteni/Kryemekaniku që lidhen me specifika të detyrave që do kryhen si më poshtë;

Sistemimi i kavove dhe kavovistove:

- të përzgjedhë mjeteve të punës;
- të sigurohet për zonën ku do të shtrihen kavot dhe kavovistot për balancim dhe kontroll;
- të lidhë mirë të dy fundet e kavovistovave në një automjet lëvizës;
- të komunikojë me operatorin e vinçit të tratës për bashkërendimin e fillimit lëshimit, për të ndaluar dhe mbledhur kavon në përfundim të procesit;
- të lëvizë mjetin ku janë kapur kavot me qëllim shtrirjen e tyre në drejtimin e caktuar;
- të kryejë lëvizjet dhe ndalimin e mjetit ku janë kapur kavot duke u komunikuar dhe bashkërenduar me operatorin e vinçit të tratës;
- të kontrollojë për dëmtime të mundshme të kavovistove dhe kavove;

- të komunikojë me përdoruesin e mjetit lëvizës për barazimin e gjatësive;
- të kryejë kontrollin dhe zëvendësim ku duhet të shenjave të gjatësisë tek kavot dhe kavovistot;
- të komunikojë me operatorin e vinçit të tratës për të filluar mbledhjen mbasi janë barazuar gjatësitë duke filluar me kavot dhe më pas me kavovistot;
- të kryejë grasatimin e kavos para mbledhjes në tamburot e vinçit;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës

Verifikimi i rregullsisë së sistemit nga timonët deri tek shulat e tratës:

- të numrojë me kujdes dhe saktësi hallkat e gadinës së tapës;
- të numrojë me kujdes dhe saktësi hallkat e gadinës së plumbit;
- të raportojë matjet;
- të regjistrojë gadinat e kavalit të timonit ku nevojitet;
- të kontrollojë kambetat lidhëse të kavalit me “pikëpyetjen” e timonit;
- të kontrollojë gambetat (në trup dhe tek “perlat”) nga “pikëpytja” e timonit deri tek “gërshëra” që lidhet me kavoviston;
- të kontrollojë xhokolinot nga “gërshëra” deri tek shulat e tratës;
- të raportojë dëmtime, konsume, zhvidhosje, deformime, etj. të mundshme që konstaton në këtë segment të veglës së gjuetisë;
- të kryejë grasatime ku duhet;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës

Riparime të vogla të xhuntimeve në teknikën e gjuetisë:

- të kryejë zëvendësim të bagotave të konsumuara, deformuara apo ku mungojnë;
- të kryejë shtërngime apo vendosje morsetash të reja pas gacës së bagotës, sipas nevojës;
- të zmonotjë, lubrifikojë, zëvendësojë gambeta të llojeve të ndryshme;
- të kontrollojë për konsume, deformime, plasaritje dhe zëvendësojë xhokolino, sipas nevojës;
- të kontrollojë për konsume, deformime, plasaritje dhe zëvendësojë çelësat profesional tek timoni i tratës, sipas nevojës;
- të kontrollojë për konsume, deformime, dëmtime të kavos së tapes dhe të plumbit të tratës;
- të kontrollojë dhe zëvendësojë, sipas rastit, poçat dhe plumbat

- e dëmtuar apo ku mungojnë;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi mer pjesë në grup për kryerjen e punimeve në hapësira të mbyllura, jashtë bordit dhe në lartësi.

Kriteret e vlerësimit:

Punime në hapësira të mbyllura

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të familjarizohet nga Kapiteni me skemën e hapësirës së mbyllur ku do të kryhet puna dhe të hapësirave përqark;
- të familjarizohet nga Kapiteni me problemin aktual/të mundshëm, shkaqet, pasojat, etj. në hapësirën e mbyllur;
- të sigurohet për efektet në/nga hapësirat e tjera përqark hapësirës ku ka dalë problemi;
- të përgatisë materialet dhe veglat e punës;
- të kryejë hapjen e kapakëve të hapësirës së mbyllur për qëllime ajrosje;
- të sigurohet për nivelet e pranuar të oksigjenit dhe të avujve të tjerë toksikë të mundshëm;
- të veshë mjetet e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- të sigurohet për funksionimin e rregullt të mjeteve të komunikimit me mbikqyrësin e punës;
- të përsërisë kodet e komunikimit të situatës dhe të emergjencës me mbikqyrësin e punës;
- të përdorë teknikën profesionale për akses, depërtim, kryerjen e punës, raportimin dhe daljen nga hapësira e mbyllur;
- të mbajë evidenca fotografike të situatës para dhe pas kryerjes së punës në hapësirën e mbyllur;
- të raportojë situatën dhe kryerjen e punës mbas daljes;
- të kryejë hermetizimin e kapakëve të hapësirës së mbyllur mbas kryerjes së punës;
- të vendosë në vendet e duhura në gjendje të gatshme për ripërdorim mjetet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;

Punime jashtë bordit dhe në lartësi:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të familjarizohet nga Kapiteni me skemën e vendit jashtë bordit ku do të kryhet puna dhe të hapësirave brenda saj;
- të familjarizohet nga Kapiteni me detyrën dhe hapat e punës;
- të sigurohet që kushtet meteorologjike nuk pengojnë kryerjen e punës jashtë bordit;

- të sigurohet për efektet në mjedis nga kryerja e punës në zonën jashtë bordit;
 - të përgatisë materialet dhe veglat e punës;
 - të përgatisë skelerinë me cimave të siguruara në skaje;
 - të sigurohet për lidhjen e skajeve të cimave në vende të sigurta në bord si pasteka, kacaskota, capuj, etj. duke ulur skelën në vendin e përshtatshëm për punë jashtë bordit;
 - të veshë mjetet e sigurisë dhe shëndetit në punë përfshirë:
 - Helmetën, syzet mbrojtëse, tapat e veshëve, dorezat dhe këpucët e punës, kominoshet, etj.;
 - Brezin e shpëtimit;
 - Brezin e punës në lartësi;
 - Sigurimin në bord të mekanizmit kundra rënies aksidentale nga lartësia;
 - të sigurojë dhe ulë shkallën e pilotit deri në vendin ku do të punohet jashtë bordit;
 - të sigurohet për funksionimin e rregullt të mjeteve të komunikimit me mbikqyrësin e punës;
 - të përsërisë kodet e komunikimit të situatës dhe të emergjencës me mbikqyrësin e punës;
 - të ulë veglat e punës me kujdes tek vendi ku do të punohet;
 - të zbresë/ngjitet me kujdes të shtuar nëpërmjet shkallës së pilotit për tek vendi i punës;
 - të përdorë teknikën profesionale për kryerjen e punës jashtë bordit;
 - të mbajë evidenca fotografike të situatës para dhe pas kryerjes së punës në zonën jashtë bordit;
 - të raportojë situatën dhe kryerjen e punës mbas përfundimit;
 - të vendosë në vendet e duhura në gjendje të gatshme për ripërdorim mjetet dhe veglat e punës;
 - të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije në port
- Kapiteni duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të praktikave të aplikueshme për kryerjen e punimeve riparuese-mirëmbajtëse gjatë qëndrimit në port.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset dhe detyrat gjatë qëndrimit në port.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të

e domosdoshme për realizimin e modulit	sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Anije e pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet e duhura. - Pajisjet individuale të shpëtimit për të gjithë nxënësit. - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj. - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
---	---

2. Moduli “Lundrim”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	LUNDRIM	M-16-1285-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në përgatitjen e anijes së peshkimit për lundrim dhe realizimin e lundrimit të sigurtë në funksion të gjuetisë së peshkut.	
Kohëzgjatja e modulit	87 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK ne drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	<p>Nxënësi asiston në përgatitjen e mjetit për lundrimin.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë hartat e duhura dhe të nevojshme për lundrimin e planifikuar sipas udhëzimit të Kapitenit; - të bashkëpunojë me Kapitenin për planizimin në hartë të lundrimit, për përcaktimin e kurseve deri në zonën e gjuetisë; - të llogarisë rezervat ushqimore, të ujit të pijshëm, hidrokarbure dhe në ambalazh të nevojshëm dhe në sasi të mjaftueshme për gjuetinë e planifikuar - të realizojë kontrolle paraprake të gjendjes teknike të mjetit të lundrimit lidhur me mjetet Zjarrfikëse, mjetet e shpëtimit, siguria e veglave të gjuetisë (lidhja e sigurtë e tyre), dritat e lundrimit, kontrolli i anës së jashtme të dukshme strukturore të mjetit të lundrimit, etj. - të kontrollojë dokumentacionin për lundrim (kontrolli i çertifikatave të flamurit dhe të klasit, çertifikatat e ekuipazhit, kopje roli, lista e ekuipazhit, bashkëpunimi me dispeçerinë e

- peshkimit për nisjen për lundrim të mjetit;
- të raportoje tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi asiston në kryerjen e një lundrimi të sigurtë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të bashkëpunojë me Kapitenin për organizimin e punës dhe të shërbimit për shmangien e tejlodhjes;
- të mbajë timonin sipas një komande dhe kursi të dhënë gjatë gjithë kohës së shërbimit;
- të përcaktojë vendodhjen e anijes në hartë me azimute dhe largësi të matura nga objektet bregdetare në ekranin e radarit;
- të përcaktojë vendodhjen e anijes në hartë me azimute të mara nga objektet bregdetare duke përdorur pelengatorin;
- të përcaktojë shpejtësinë e lëvizjes së anijes me anë të pozicioneve të vendodhjes, duke përdorur logun mekanik dhe me mjete rrethore pluskuese duke bërë matje me kronometër;
- të shfaqë simbolet e REPAD për situatën e mjetit lundruar në gjueti peshku e sipër;
- të monitorojë treguesit e ndryshëm që ndodhen në urën e komandës si të xhirove, timonit, etj.
- të raportoje për çdo situatë;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi asiston në planizimin dhe organizimin e punës për kthimin e mjetit të lundrimit në port.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të sigurojë veglat e gjuetisë (lidhja e sigurtë e tyre)
- të përcaktojë kursin për kthim të anijes në port;
- të realizojë detyrat në shërbim si vrojtimi, raportimi, mbajtja e timonit, ditën dhe natën i mbikqyrur periodikisht dhe në kushtet e mjergullës jo pa praninë e një detari të kualifikuar;
- të raportoje objektet dhe dinamikën e tyre, që sheh dhe dëgjon nga vëzhgimi përreth mjetit lundruar;
- të realizojë një patrullim në mbistrukturë gjatë lundrimit;
- të realizojë me asistencë, hedhjen/ngritjen e spirancës së

- mjetit lundruës;
 - të kryejë shërbim vrojtimi gjatë qëndrimit të anijes në spirancë;
 - të identifikojë fenerët dhe ndihmuesit e tjerë detar në bazë të karakteristikave;
 - të mbajë shënimet e duhura sipas poroive të Kapitenit;
 - të njoftojë menjëherë Kapitenin kur paraqitet një situatë e pazakontë apo kurdo që i është kërkuar të njoftojë;
 - të kryejë kontrolle të funksionimit dhe temperatures së çelës frigoriferike;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
 - të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri
 - të mirëmbajë vendin e punës
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije në lundrim
- Kapiteni duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të praktikave të aplikueshme për një lundrim të siguritë të anijes.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset dhe detyrat para, gjatë dhe në mbërritje nga lundrimi.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Anije e pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet e duhura për lundrim të sigurtë.
 - Pajisjet individuale të shpëtimit për të gjithë nxënësit.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

3. Moduli “Përdorimi i pajisjeve radionavigacionale GMDSS”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PERDORIMI I PAJISJEVE RADIONAVIGACIONALE GMDSS	M-30-1883-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në shfrytëzimin e njohurive për të përfituar shprehitë në përdorimin e pajisjeve dhe mjetet radionavigacionale të disponueshme në anije.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përdor radarin, ehollotin, xhirobusullën dhe autopilotin gjatë lundrimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- Radari –- të ndezë, ndryshojë kufirin e matjes, ndryshojë fushën e lëvizshme në raport me vijën e besimit të drejtimit të lëvizjes, reduktojë ekot false, rrisë ndjeshmërinë, zmadhojë dhe zvogëlojë intensitetin e ndriçimit të ekranit dhe fikë radarin;- të orientohet për drejtimin e lëvizjes së mjetit lundrues në raport me vijën e besimit, busullën, gps, objektet bregdetare, mjete të tjera lundruese për qark dhe/ose ndihmues lundrimor, etj.- Eholloti –- të ndezë, zmadhojë dhe zvogëlojë intensitetin e ndriçimit ose shkrimit (në varësi të llojit të instaluar), reduktojë ekot false dhe rrisë ndjeshmërinë dhe fikë ehollotin;	

- të ferifikojë thellësinë e matur nga eholoti duke e krahasuar me thellësinë e hartës në pozicionin e vendodhjes së përcaktuar;
 - të identifikojë ekot false dhe të atyre që tregojnë praninë e tufave peshkore, thellësinë në të cilën ndodhen dhe t'ia raportojë Kapitenit.
 - Xhirobusulla –
 - të ndezë në kohë, kontrollojë nivelin e lëngut pluskues në raport me nivelin e mesit të xhirosferës, të bëjë krahasime të treguesit të busullës xhiroskopike me atë magnetike ose gps dhe të fikë xhirobusullën;
 - Autopiloti –
 - të ndezë autopilotin mbas ardhjes në meridian të xhirobusullës, zbatojë procedurat e kalimit nga drejtimi me timonin me dorë në atë me autopilot, raportojë kalimin dhe të fikë autopilotin;
 - të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.
 - të mirëmbajë vendin e punës.
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi përdor NAVTEX, Blue Box, AIS, GPS dhe sonarin gjatë lundrimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- NAVTEX –
- të ndezë, interpretojë mesazhet e mara nga stacionet bregdetare, raportojë Kapitenit, vendosë letrën e re pas mbarimit të asaj ekzistuese dhe fikë navtex-in.
- Blue Box –
- të ndezë, përdorë për transmetimin e të dhënave nga gjuetia dhe të pozicionit të anijes tek stacioni i përcaktuar bregdetar dhe fikë blue-box-in.
- AIS –
- të ndezë, identifikojë mjetet lundruese që pasqyhen në ekran duke i krahasuar me pamjen me ekranin e radarit, përqark mjetit lundrues dhe në horizont me pamje të lirë, të regjistrojë të dhënat lundrimore, dërgojë dhe lexojë mesazhe, etj. funksione sipas llojit të paisjes;
- GPS –
- të ndezë dhe fikë sipas nevojës gps-në;
- të interpretojë saktë dhe krahasojë të dhënat e GPS në raport me paisjet e tjera radionavigacionale si radari, busulla, xhirobusulla, AIS, etj. si dhe me rrethanat reale, me objektet bregdetare, etj.
- të përcaktojë vendodhjen e anijes nga të dhënat e mara nga GPS;

- të krahasojë dhe interpretojë ndryshimet mbi vendodhjen e përcaktuar nga GPS me atë të matur me paisje të tjera si radar, pelengator, etj.
- Sonari –
- të përdorë sonarin në mjetet e lundrimit ku është instaluar;
- të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi përdor paisjet e radiokomunikimit detar të zonës A1 të instaluar në anije.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndezë radion VHF (very high frequency) të llojit DSC (digital selective call) të instaluar në anije;
- të transmetojë me anë të radios, në frekuencën (kanalin) e përcaktuar siç është:
 - njoftim kapitenerisë për nisje të mjetit lundrues për gjueti;
 - njoftim kapitenerisë për dalje nga porti të mjetit lundrues;
 - raportim dispeçerisë së peshkimit të zonës së parashikuar për gjueti;
 - komunikim për siguri trafiku me mjetet e tjera lundruese në lundrim të lirë, në situata emergjence, mos ndryshim të këndit kursor me mjete lundruese përqark, kur ndodhet në gjueti e sipër, etj.;
 - komunikim në rastet e operacioneve SAR të kërkim shpëtimit;
 - anulim të një alarm të dhënë fals;
- Hedh shënimet e komunikimit në ditarin e lundrimit;
- Raportimi Kapitenit për konstatimet, funksionimin e paisjeve të radios dhe mesazhe të mara nga përgjuesi automatik i frekuencës së avarisë 156,8 MHz ose kanali 16;
- të mirëmbajë dhe përdorë radiot e dorës të emergjencës përfshirë gatishmërinë e baterive një përdorimshe;
- testi i EPIRB-it;
- testi i SART-it nëpërmjet Radarit;
- të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije në lundrim
- Kapiteni duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të praktikave të aplikueshme të komunikimit detar, përdorimit të paisjeve radionavigacionale të instaluar në anije për një lundrim të sigurtë dhe efikas në anijes.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset dhe detyrat para, gjatë dhe në mbërritje nga lundrimi.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Anije e pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet e duhura të radionavigacionit të instaluar në anije për të realizuar një lundrim të sigurtë dhe efikas.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

4. Moduli “Gjuetia e peshkut në det”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	GJUETIA E PESHKUT NË DET	M-16-1286-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në përgatitjen për lundrim, realizimin e procesit të gjuetisë me trata kiçi, me trata binjake, me koshilok në det të hapur dhe me grepa dhe gracka në bregdet.	
Kohëzgjatja e modulit	135 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK ne drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi merr pjesë në gjuetinë e peshkut me trata kiçi (fundore). Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë <ul style="list-style-type: none">- të veshë mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë- të përgatisë për hedhje në ujë e veglës së gjuetisë- të asistojë në teknikën e hedhjes së veglës së gjuetisë në ujë- të ndjekë procesin e gjuetisë (qëndrim në timon, monitorim);- të përgatitet për marjen në bord të veglës së gjuetisë nga uji;- të përdorë mekanizmat e kuvertës për marjen e veglës së gjuetisë në bord;- të asistojë në teknikën e marjes në bord të veglës së gjuetisë nga uji;- të kryejë riparime të vogla të dëmtimeve të veglës së gjuetisë;- të asistojë në teknikën e ri-hedhjes në ujë të veglës së gjuetisë pas zbrazjes së produkteve të zëna;- të kryejë në mënyrë të përsëritur veprimet e sipërpërmendura

- për çdo kalatë gjuetie;
 - të asistojë në stivimin e tratës në platformën e ruajtjes mbas përfundimit të gjuetisë gjatë kthimit në port;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.
 - të mirëmbajtjë vendin e punës
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi merr pjesë në gjuetinë e peshkut me trata binake (pellagjike)

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të bashkëpunojë me Kapitenin për planizimin e manovrës për pozicionim në raport me anijen tjetër për hedhjen e tratës pellagjike në det;
- të komunikojë dhe bashkërendojë hapat e punës për pozicionim të anijes, hedhje dhe marje nga uji të veglës së gjuetisë;
- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të marrë pjesë në përgatitjen për hedhjen në ujë të veglës së gjuetisë;
- të marrë pjesë në realizimin e teknikës së hedhjes së veglës së gjuetisë pellagjike në ujë;
- të punojë me mekanizmat e kuvertës për hedhjen e veglës së gjuetisë në ujë;
- të komunikojë me radio dhe bashkërendojë veprimet me anijen tjetër gjatë gjithë kohës së kalatës (tratës në ujë);
- të punojë me mekanizmat e kuvertës për marjen e veglës së gjuetisë në bord;
- të marrë pjesë në realizimin e teknikës së marjes së veglës së gjuetisë në bord dhe zbrazjen e produkteve të zëna nga trata;
- të marrë pjesë në grup për ri-hedhjen në ujë të veglës së gjuetisë pas zbrazjes së produkteve të zëna;
- të kryejë në mënyrë të përsëritur veprimet e mësipërme për çdo kalatë gjuetie;
- të sistemojë peshkun në ambalazhe dhe vendosë në çelën frigoriferike;
- të asistojë në stivimin e tratës në platformën e ruajtjes mbas përfundimit të gjuetisë gjatë kthimit në port;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe gazi.
- të mirëmbajtjë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi merr pjesë në gjuetinë e peshkut me kosh notues (koshilok)

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të marrë gradualisht linjën elektrike me ndriçuesit për mbledhjen e peshkut;
- të njoftojë në kohë feneristin;
- të asistojë feneristin në vendosjen e petromaksit, pajimeve përfshirë cimën e tapave dhe kavon e peshave në sanallin e tij;
- të kryejë zgjimin e ekuipazhit në kohë për fillimin e operacioneve të rrethimit;
- të marrë pjesë në kalimin e kavos me peshat unaza në tajat e përcaktuara;
- të marrë pjesë në asistencën e lëshimit të kavos me peshat dhe tapave në momentin kur feneristi njofton “molla”!
- të marrë kavon e peshave pas përfundimit të rrethimit nga sanalli i feneristit;
- të vendosë kavon e peshave në tamburo dhe të fillojë virimin;
- të vendosë cimën e tapave dhe përlyhurën në powerblock dhe të fillojë virimin;
- të stivojë peshat në ullukun e tyre;
- të stivojë përlyhurën e koshit notues në kuvertën e kështjës;
- të asistojë në marjen e peshkut nga koshi notues dhe të zbrazë atë në arka ose në kuvertën e kështjës;
- të asistojë në marjen e pajimeve të feneristit në bord;
- të sistemojë peshkun në ambalazhe;
- të lagë peshkun në arka me ujë deti gjatë kthimit në port;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe gazi.
- të mirëmbajtjë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi merr pjesë në gjuetinë e peshkut me grepa dhe gracka në bregdet me anije

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të vendosë paimet nga anija në sanall;
- të vendosë koshin me vargun e grepave dhe kutiat gracka në sanall;
- të vozisë nga anija deri në vendin e parashikuar për hedhjen e grepave dhe të grackave;
- të realizojë hedhjen e peshave, pluskuesve dhe grackave në vendin e parashikuar me vozitje të njëkohësishme;

- të realizojë mbledhjen e grepave pas kohës përcaktuar të qëndrimit në ujë të grepave me vozitje të njëkohësishme;
- të heqë peshkun e zënë në grepa dhe t'i vendosë në arkën e parashikuar;
- të mbledhë peshat dhe pluskueset në fillim dhe në fund me vozitje të njëkohësishme ;
- të vozisë për mbledhjen e peshave, pluskuesve të grackave me peshkun e zënë në to dhe t'i vendosë në sanall për t'u zbrazur në anije;
- të vozisë për kthimin tek anija me sanall;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajtjë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi kryen punime mirëmbajtëse të veglave të peshkimit të dëmtuara nga gjuetia.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të përzgjedhë mjetet dhe veglat e punës;
- të kryejë riparime të thjeshta të dëmtimeve të pëlhurës në litarin e pluskuesve;
- të kryejë riparime të thjeshta të dëmtimeve të pëlhurës në litarin e peshave;
- të kryejë riparime të thjeshta të dëmtimeve në pëlhurën e thesit;
- të realizojë mbushje me syza të dëmtimeve në vende të ndryshme të tratës;
- të realizojë arrime me pëlhurë të ngjashme të zonave të dëmtuara në tratë;
- të kryejë zëvendësime dhe lidhje në litar të pluskuesve të dëmtuar;
- të realizojë përforcime të zonave të dobësuara në pëlhurë dhe litarë të veglës së gjuetisë;
- të kryejë zëvendësime të gadinave të dëmtuara në timonët e tratës;
- të kryejë riparime të pjesëve të dëmtuara të timonëve të tratës;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Udhëzime për
zbatimin e
modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në anije peshkimi në lundrim
- Kapiteni/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve që zbatohen në gjuetinë e peshkut sipas teknikave mësipërme.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset e gjuetisë së peshkut me teknikat e sipërpërmendura.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Anije peshkimi me veglat e gjuetisë me trata kiçi, trata pellaçjike, koshilok në det të hapur
 - Anije peshkimi me veglat e gjuetisë me grepa dhe gracka në bregdet.
 - Mjete pune të trajtimit paraprak të peshkut në anije.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde, manuale teknike etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

5. Moduli “Përpunimi paraprak i peshkut”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI PARAPRAK I PESHKUT	M-16-1365-17
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer proceset bazë të përpunimit të peshkut si atij paraprak në anije direkt pas gjuetisë ashtu edhe më tej në stabilimentet e grumbullimit dhe ruajtjes së peshkut.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK ne drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi mer masat paraprake higjenike për sistemimin e peshkut para dhe pas gjuetisë Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të mbajë veshur mjetet vetjake të mbrojtjes në punë;- të bashkëpunojë me detar të kualifikuar për punën;- të nxjerë shllangën e ujit të detit nga kutia dhe t’u shtrijë atë gati për përdorim;- të vendosë piphin e shllangës në saraçineskën e sistemit zjarrfikës;- të hapë saraçineskën e sistemit zjarrfikës;- të komunikojë me sektorin e makinerisë për gatishmërinë për larje të kuvertës;- të lajë me ujë deti kuvertën ku do të vendoset vegla e gjuetisë dhe peshku;- të nxjerë ambalazhet nga depo dhe t’i vendosë aty ku nuk

-
- pengon aktivitetin për marjen e veglës së gjuetisë;
 - të kontrollojë ambalazhin për dëmtime të mundshme;
 - të shplajë me ujë deti ambalazhin;
 - të ri-shplajë kuvertën me ujë deti mbas ri-hedhjes së veglës së gjuetisë në ujë për kalatën e radhës;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit detar në kryerjen e detyrave në kuvertë;
 - të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë

RN 2 Nxënësi kryen përzgjedhjen e peshkut pas gjuetisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë;
- të përzgjedhë peshkun sipas kategorisë, llojit, madhësisë, etj.
- të evidentojë dhe ndajë veçantë peshqit e dyshuar si të sëmurë, të dëmtuar nga vegla e gjuetisë, egërsira, etj.;
- të vendosë arkat e ambalazhit pranë kuvertës së kështjës ku ndodhet peshku i zënë;
- të përdorë teknikën e duhur për vendosje të peshqve në ambalazh për të shmangur dëmtimet;
- të bëjë kujdes nga peshqit helmues dhe dëmtues duke u këshilluar me detarë me përvojë;
- të bëjë kujdes nga rrëshqitjet e mundshme në kuvertë duke shmangur kalimin në vende ku ka qenë vendosur peshku apo ka prani vajore;
- të bëjë kujdes për të shmangur daljen jashtë bordi në det;
- të përdorë akullin për frutat e detit;
- të përdorë plastmasin për peshqit me konsistencë mishtore delikate para hedhjes së akullit mbi to;
- të përsërisë këtë proces për çdo kalatë gjuetie;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit detar në kryerjen e detyrave në kuvertë;
- të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi vendos peshkun në çelën frigoriferike

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përdorë mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në

- punë;
- të bashkëpunojë në grup për vendosjen e arkave të ambalazhit me peshk në çelën frigoriferike;
 - të sigurojë arkat në çelën frigoriferike për të mos u rrëzuar nga lëkundjet e detit;
 - të zbatojë teknikën e stivimit dhe vendosjes së arkave të ambalazhit në çelën frigoriferike sipas peshëmbajtjes së arkave në lartësi;
 - të realizojë mbylljen hermetike të çelës frigoriferike;
 - të vendosë me anë të rregullatorit temperaturën e ruajtjes deri në -20°C ;
 - të monitorojë temperaturën gjatë lundrimit;
 - të monitorojë punën e kompresorit të frigoriferit gjatë lundrimit;
 - të raportojë për çdo gjendje normale apo jo-normale të punës së frigoriferit;
 - të përsërisë këtë proces për çdo kalatë gjuetie;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
 - të zbatojë rregullat e shëndetit, sigurisë dhe higjenes gjatë punës në vende me temperatura mjaft të ulta;
 - të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi kryen procese të përpunimit paraprak të peshkut
Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë i aftë:

- të përdorë mjetet mbrojtëse të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të përzgjedhë mjetet dhe veglat e punës;
- të bashkëpunojë në grup për përgatitjen e një mjedisi sa më higjenik për përpunimin paraprak;
- të kryejë pastrimin e peshkut nga pa-pastërtitë e mbledhura bashkë me veglën e gjuetisë;
- të ndajë veçantë peshqit e dëmtuar nga vegla e gjuetisë, egërsirat apo të sëmurë;
- të realizojë hapjen dhe pastrimin e organeve të brendshme të peshqve me potenciale të mëdha të dekompozimit të brendshëm si peshku pëllumb, peskatriçet, peshqit e familjes së rajave, etj.;
- të realizojë me teknikën e duhur shplarjen me ujë deti të peshkut në arkat e ambalazhit para vendosjes së akullit;
- të realizojë me teknikën e duhur vendosjen e shtresës së akullit mbi produktet e gjuetisë;
- të realizojë teknikën e përdorimit të plastmasit para akullit në peshqit delikatë si barbun, merluc, açuge, etj.;
- të realizojë teknikën e duhur vendosjen së arkave të ambalazhit në vende ku nuk rrezikon rrëzimin apo daljen

- jashtë bordit në det;
 - të bëjë kujdes për ruajtjen e vetes nga rrëshkitjet në kuvertë apo daljen jashtë bordit në det;
 - të përsërisë këtë proces për çdo kalatë gjuetie;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit detar në kryerjen e detyrave në kuvertë;
 - të pastrojë vendin e punës
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Pyetje-përgjigje me gojë
 - Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi kryen shërbime në stabilimentin e mbledhjes dhe ruajtjes së peshkut.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me teknikën e duhur pastrimin e peshkut për klientët rastësor;
- të realizojë me teknikën e duhur pastrimin e peshkut dhe produkteve të tjera të detit për konservim;
- të realizojë me teknikën e duhur pastrimin e karkalecit për konservim;
- të vendosë dhe të monitorojë ngrirjen e thellë -50°C dhe -70°C për afat të gjatë kohor të qëndrimit të peshkut në frigorifer;
- të kontrollojë sipas periodicitetit të caktuar punën e kompresorit të çelës frigoriferike;
- të vendosë dhe të monitorojë ngrirjen normale -20°C për periudha afatmesëm të ruajtjes së peshkut në frigorifer;
- të realizojë me teknikën e duhur ndërrimin e pozicionit vertikalisht të arkave të ambalazhit me bazë javore për ruajtjen sa më shumë të konsistentës mishtore;
- të realizojë me teknikën e duhur ruajtjen e freskim të produkteve të peshkut në çelën frigoriferike deri në -4°C për periudha afat shkurtra;
- të përgatitë vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura të për regje;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e shëndetit, sigurisë dhe higjenës gjatë punës në vende me temperatura mjaft të ulta të stabilimentit të ruajtjes së peshkut;
- të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në sektorë anije në lundrim për gjueti peshku dhe në stabilimentet e mbledhjes dhe ruajtjes së peshkut.
- Kapiteni/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve të ndryshme të përpunimit paraprak të peshkut përfshirë procesin e ruajtjes në frigorifer.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset e ndryshme të përpunimit paraprak të peshkut përfshirë në procesin e ruajtjes në frigorifer.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- anije peshkimi detar.
 - stabiliment të mbledhjes dhe ruajtjes së produkteve të detit
 - mjete pune të përpunimit paraprak të peshkut.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde, manuale teknike etj.
-

6. Moduli “Punime ndihmëse elektromekanike në sektorin e makinerisë së anijes”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NDIHMËSE ELEKTROMEKANIKE NË SEKTORIN E MAKINERISË SE ANIJES	M-24-1287-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të realizuar asistencë dhe veprime të orientuara në sektorin e makinerisë së mjetit të lundrimit.	
Kohëzgjatja e modulit	87 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi asiston në furnizimin me karburant të mjetit lundruar Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë dokumentacionin teknik përkatës;- të analizojë skemën e tankeve ku do të futet karburanti;- të masë gjendjen aktuale të karburantit në tank;- të kontrollojë dhe përgatisë sistemin e tubacioneve, saraçineskave të furnizimit dhe të ajrosjes së tankut të parashikuar;- të përgatisë vendin e punës për kryerjen e veprimeve për furnizimin me karburant;- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës sipas	

-
- standardeve teknologjike dhe teknike;
 - të marë masat për furnizim karburant të mjetit lundrues sipas udhëzimit të krye/mekanikut;
 - të marë masat kundra zjarrit (flamuri i kuq, bombola ZF, kontroll me sy për punime të mundshme saldimi në afërsi të mjetit lundrues, etj.);
 - të marë masat kundra ndotjes (tallazhi, sfungjerët, pykat për burnelat, kova, lecka, etj.);
 - të hapë saraçineskat e linjës së furnizimit me karburant;
 - të realizojë lidhjen e tubacioneve të furnizimit nga autoboti me valvolën e furnizimit të karburantit;
 - të evidentojë pozicionin e matjes së tankut;
 - të kontrollojë nivelin dhe ndarjet e shiritit mates;
 - të realizojë hapjen e tapës së tankut dhe vendosë atë në vend të sigurtë gjatë matjes;
 - të përdorë ngjyrues për evidentimin e lagies së shiritit matës në zonën e nivelit të pritshëm për lagie nga karburanti;
 - të ushtrojë refleksin e ndjeshmërisë për të kutptuar prekjen e peshës së shiritit matës në fundin e tankut;
 - të nxjerë me kujdes për të mos shkaktuar ndotje nga shiriti dhe të bëjë leximin e tij;
 - të llogarisë sasinë e karburantit të furnizuar duke e krahasuar me tabelën e volumeve të tankut për njësi matje;
 - të raportojë për sasinë e karburantit të furnizuar;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale ;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes ndaj zjarrit si dhe mbrojtjes së mjedisit;
 - të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi mat tanket dhe raporton gjendjen e hidrokarbureve në anije

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë me kujdes dokumentacionin përkatës teknik dhe skemën e tankeve;
- të përgatitë vendin e punës për kryerjen e matjes;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura të punës sipas teknikës së aplikueshme në mjetin e lundrimit;
- të kontrollojë nivelin dhe ndarjet e shiritit matës për rregullsinë e progresit të numerizimit;
- të përdorë veglën e duhur për hapjen e tapës së tankut dhe vendosë atë në vend të sigurtë gjatë matjes;
- të përdorë ngjyrues për evidentimin e lagies së shiritit matës në zonën e nivelit të pritshëm për lagie nga hidrokarburi;
- të ushtrojë refleksin e ndjeshmërisë për të kutptuar prekjen e peshës së shiritit matës në fundin e tankut të naftës;

- të ushtrojë refleksin e ndjeshmërisë për të kutptuar prekjën e peshës së shiritit matës me sipërfaqen shtresës së mazutit;
- të nxjerë me kujdes për të mos shkaktuar ndotje nga shiriti dhe të kryejë leximin e tij;
- të llogarisë sasinë e karburantit duke e krahasuar me tabelën e volumeve të tankut përkatës për njësi matje;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të raportojë sasinë e hidrokabureve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së tankeve;
- të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi kryen transferimin e mbetjeve hidrokarbure në tankun e mbledhjeve

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë me kujdes dokumentacionin përkatës teknik dhe të skemës së tankeve;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës për kryerjen e transferimit të mbetjeve hidrokarbure në tankun e mbledhjeve;
- të kryejë hapjen e panjollave të dyshemesë së lokalit të makinerisë;
- të realizojë kontrollin dhe masë nivelin e mbetjeve në sentinë;
- të kryejë matjen e sasisë së mbetjeve hidrokarbure në tankun e mbledhjes;
- të kryejë hapjen e saraçineskave të linjës së tubacioneve për thithjen e sentinave për transferim tek tanku u mbledhjes;
- të realizojë takimin e pompës së sentinave për transferim tek tanku i mbledhjeve;
- të ndjekë punën normale të pompës, ndryshimit të nivelit të sentinave dhe në tankun e mbledhjes;
- të stakojë pompën e sentinave në kohë për të shmangur punën në zbrazëti apo derdhjen nga tanku i mbledhjeve;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të raportojë sasinë e hidrokabureve të transferuara dhe gjendjen totale në tankun e mbledhjeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë transferimit të mbetjeve nga sentinat në tankun e mbledhjes së mbetjeve;
- të pastrojë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi transferon mbetjet hidrokarbure në impiantin e grumbullimit portual

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë me kujdes dokumentacionin përkatës teknik dhe të skemës së tankeve të mbledhjes;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës për kryerjen e transferimit të mbetjeve hidrokarbure në impiantin e grumbullimit portual;
- të masë sasinë e mbetjeve hidrokarbure në tankun e mbledhjes;
- të realizojë hapjen e saraçineskës së linjës së tubacioneve për transferim nga tanku i mbledhjeve të mbetjeve hidrokarbure për tek valvola e dorëzimit në impiantin portual të mbledhjes;
- të rakordojë me personelin e autobotit të mbledhjes për gatishmërinë e fillimit të transferimit edhe nga ana e tij;
- të realizojë takimin e pompës së transferimit nga tanku i mbledhjeve për tek autoboti i mbledhjes portuale;
- të ndjekë punën normale të pompës, ndryshimit të nivelit të tankut dhe në tubacionet e transferimit për të shmangur derdhjet;
- të realizojë stakimin e pompës së transferimit në kohë për të shmangur punën në zbrazëti me përfundimin e procesit të transferimit;
- të realizojë ndalimin normal dhe në raste avarie të pompës së transferimit;
- të raportojë për kryerjen e procesit dhe sasisë së transferuar në autobot dhe sasisë së mbetur në tankun e mbledhjes;
- të parandalojë dhe eliminojë avari të mundshme në procesin e transferimit të mbetjeve hidrokarbure;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së tankeve
- të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi kryen shërbime ndihmëse në lokalin e makinerisë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë për ndezje motogjeneratorin e caktuar;
- të realizojë ndezjen e motogjeneratorit;
- të raportojë leximet e parametrave të punës së motogjeneratorëve (temp. gazrat, pompë vaji, pompë ftohje, rrjedhje, etj.);
- të realizojë takimin e çelësit në panelin e kuadrit shpërndarës për dhënie energjie mekanizmave të ndryshme në kurvetë;

- të interpretojë parametrat nga leximet e treguesve tek paneli elektrik;
- të realizojë prova paraprake pa ngarkesë të mekanizmave në kuvertë nën mbikqyrjen e Kryemekanikut;
- të kryejë prova me ngarkesë të mekanizmave në kuvertë;
- të ndjekë punën për kalimin e furnizimit me energji tek mekanizmat nga një moto-gjenerator tek tjetri nëpërmjet metodës së punës në parallel e gjeneratorëve;
- të realizojë fikjen e gjeneratorit të caktuar;
- të nderzë/fikë pompa të ndryshme elektrike dhe hidraulike;
- të nderzë/fikë kompresorët e ajrit dhe realizojë mbushjen e bombolave;
- të zmontojë/montojë valvola, saraçineska, tubacione, panjolla dyshemeje, kapakë të depove/tankeve;
- të përgatisë dhe vendosë gomina për izolim të rrjedhjeve në valvola/saraçineska të ndryshme;
- të marrë masat e sigurisë ndaj zjarrit në rastet e punimeve me saldim;
- të raportojë çdo situatë gjatë kryerjes së shërbimit që i caktohet;
- të sistemojë në mënyrë të sigurt veglat dhe mjetet e përdorura për shërbime mirëmbajtëse;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve në lokalin e makinerisë;
- të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 6 Nxënësi kryen shërbimin në lundrim në lokalin e makinerisë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vlerësojë matjen e nivelit dhe gjendjes së ujit të sentinave, të tankeve të ballasteve, të tankeve të mbetjeve vajore, tankeve rezervë, tankeve të ujit të ëmbël, tankeve të ujrave të zeza me atë të raportuar;
- të vlerësojë matjen e nivelit të tankeve rezervë të karburantit, të tankeve të dekantimit, të tankut ditor dhe të tankeve të tjera të mbajtjes së karburantit me atë të raportuar;
- të vlerësojë sigurinë dhe palëvizshmërinë në rrethana të detit të trazuar të pjesëve të këmbimit dhe materialeve të tjera në depo dhe magazina;
- të realizojë shkarkimin ujrave të zeza në det sipas udhëzimit;
- të raportojë gjendjen dhe mënyrën e operimit të sistemeve kryesore dhe atyre ndihmuese, përfshirë sistemin e shpërndarjes së energjise elektrike;

- të zbatojë procedurat për mënyrën e operimit në rastet e ndonjë difekti apo të një rrethane të rrezikshme për anijen;
- të përdorë sistemet e komunikimit të brendshëm;
- të verifikojë lirshmërinë e rrugëkalimeve të ikjes së emergjencës nga salla mashinës;
- të kontrollojë me sy sistemet e alarmit të sallës së mashinës;
- të vlerësojë punën e moto-gjeneratorëve
- të vlerësojë punën e kaldajës;
- të vlerësojë punën e pompës së vajit lubrifikant dhe të oljatorëve të cilindrave të Motorrit Kryesor;
- të vlerësojë punën e pompës së naftës së Motorrit Kryesor dhe spurgot;
- të vlerësojë punën e pompës së ujit ftohës së Motorrit Kryesor;
- të vlerësojë nëse ka rrjedhje vajore apo shkarkime gazrash;
- të vlerësojë thithjen e ujit të detit dhe qarkullimit për ftohje;
- të vlerësojë nivelin e tubit të vajit hidraulik të sistemit të drejtimit dhe lëvizjes;
- të bëjë kontrollin e punës së turbines;
- të bëjë kontrollin e punës së valvolave të ndryshme të Motorrit Kryesor dhe motogjeneratorëve;
- të verifikojë gjendjen e mbushjes së bombolave të ajrit;
- të vlerësojë parametrat e punës së Motorrit Kryesor dhe Moto Gjeneratorëve si temperatura, gazrat me atë të raportuar;
- të vlerësojë punën e kompresorit të çelës frigoriferike dhe monitorim të temperaturës me atë të raportuar;
- të raportojë çdo situatë gjatë kryerjes së shërbimit që i caktohet;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve në lokalin e makinerisë
- të pastrojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije në port dhe në lundrim.
- Mësuesi/Mekaniku i caktuar për mbikqyrjen e punës së nxënësit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve dhe raportimit përkatës për detyrat dhe situatat e paraqitura në lokalin e makinerisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset e punës në lokalin makinerisë së mjetit të lundrimit.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- anije në port
- anije në lundrim për qëllime peshkimi apo tregtare
- mjetet e punës të disponueshme në anije.
- pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Punime mirëmbajtëse në anijen e peshkimit mbi ujë”

Drejtimi: Detari
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME MIRËMBAJTËSE NË ANIJEN E PESHKIMIT MBI UJË	M-16-1366-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për kryerjen e disa punimeve të thjeshta mirëmbajtëse në anijet e peshkimit mbi ujë	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK ne drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zëvendëson majeret e dëmtuara mbi kuvertën metalike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe 	

-
- sigurisë në punë;
 - të konsultohet me Kapitenin për planin e punës dhe efektet në pjesë të tjera të strukturës së anijes;
 - të përzgjedhë veglat e punës;
 - të përgatisë vendin e punës;
 - të marrë masat e majeres kampion;
 - të asistojë në përgatitjen e majeres zëvendësuese në repartin e karpenterisë për punime në mjete lundruese;
 - të realizojë lirimin me kujdes të dadove që kanë fiksuar majeren së dëmtuar;
 - të realizojë me teknikën e duhur heqjen e majeres pa dëmtuar të tjerat në afërsi;
 - të kryejë lirimin e bulonave të konsumuar;
 - të marrë masat paraprake kundra zjarrit;
 - të asistojë në zmontimin e veshjes së tavanit nga poshtë kuvertës ku do të kryhet saldimi;
 - të asistojë për saldimin e bulonave të rinj në kuvertën metalike;
 - të kryejë pastrimin e kuvertës nga ndryshku;
 - të kryejë lyerjen e kuvertës me bojë kundra ndryshkut dhe antivegjetative me nga dy duar;
 - të kryejë prezantimin e majeres së re për montim;
 - të realizojë montimin me kujdes të majeres së re dhe të bëjë fiksimin e saj me bulonat e tyre me veglat e duhura;
 - të kryejë kallafatimin e hapësirave skajore të majeres së re duke përdorur daltën dhe çekiçin;
 - të kryejë me kujdes stukimin e hapësirave të mbushura me shtupën e kallafatit duke përdorur furçen dhe rrashpën;
 - të realizojë lyerjen me dy duar bojë antivegjetative duke respektuar kohën e tharjes nga dora në dorë;
 - të raportojë për punën e bërë kapitenit;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.
 - të mbajë pastër vendin e punës në fund të procesit..

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen punime të ndryshme ndihmëse mirëmbajtëse në kuvertë dhe skaf druri.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të konsultohet me Kapitenin për planin e punës dhe efektet në pjesë të tjera të strukturës së anijes;
- të përzgjedhë veglat e punës;
- të përgatisë vendin e punës;
- të marrë përmasat e elementëve të dëmtuar të filit;
- të marrë përmasat e elementëve të dëmtuar të capujve;

- të marë përmasat e elementëve të dëmtuar të bandës;
- të asistojë në përgatitjen në repartin e karpenterisë për mjetet e lundrimit të elementëve të dëmtuar të bandës;
- të asistojë në përgatitjen në repartin e karpenterisë të elementëve të dëmtuar të filit;
- të asistojë në përgatitjen në repartin e karpenterisë të elementëve të dëmtuar të capujve;
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për heqjen e elementëve të dëmtuar të filit pa dëmtuar pjesë të tjera të pa-dëmtuara;
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për heqjen e elementëve të dëmtuar të bandës pa dëmtuar pjesë të tjera të pa-dëmtuara;
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për heqjen e elementëve të dëmtuar të capujve pa dëmtuar pjesë të tjera të pa-dëmtuara;
- të kryejë pastrimin e vendit para montimit nga pa-pastërtitë
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për montimin e elementëve të rinj të bandës;
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për montimin e elementëve të rinj të filit;
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për montimin e elementëve të rinj të capujve;
- të përgatisë shtupën e kallafatit dhe stukon;
- të kryejë kallafatimin e hapësirave të skajeve të majereve të bandës;
- të kryejë me kujdes stukimin e hapësirave të mbushura me shtupën e kallafatit duke përdorur furçen dhe rrashpën;
- të lyejë me dy duar me bojë antivegetative të bandës, filit dhe capujve duke respektuar kohën e tharjes;
- të raportojë për punën e bërë kapitenit;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mbajë pastër vendin e punës në fund të procesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi asiston në ndërrimin e një bracolli që lidh nënkuvertën me skafin prej druri.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të konsultohet me Kapitenin për planin e punës dhe efektet në pjesë të tjera të strukturës së anijes;
- të për zgjedhë veglat e punës;
- të përgatisë vendin e punës;
- të marë përmasat e bracollit kampion;
- të asistojë në përgatitjen e bracollit zëvendësues në

- repartin e karpenterisë për mjete lundrimi;
- të kryejë lirimin me kujdes të dadove që kanë fiksuar bracollin e dëmtuar;
- të asistojë specialistin në përdorimin e teknikës së duhur për heqjen e bracollit pa dëmtuar element të tjerë në afërsi;
- të kryejë lirimin/heqjen me kujdes të bulonave/tirafondove të konsumuar ose dëmtuar;
- të marrë masat paraprake kundra zjarrit;
- të asistojë në vendosjen e bulonave/tirafondove të bracollit në tavan poshtë kuvetës;
- të kryejë pastrimin e kuvertës dhe tavanit nga papastërtitë;
- të asistojë në prezantimin e bracollit të ri për montim;
- të asistojë në montimin e bracollit dhe fiksimin me bulona ose tirafondo në tavan dhe në majeret e skafit;
- të përgatisë shtupës së kallafatit dhe stukon;
- të kryejë kallafatimin e hapësirave të skajeve të majereve ku ka nevojë duke përdorur çekiçin prej druri, daltën, etj.;
- të kryejë me kujdes stukimin e hapësirave të mbushura me shtupën e kallafatit duke përdorur rrashpën;
- të lyejë me dy duar me bojë antivegetative të majereve të kuvertës duke respektuar kohën e tharjes;
- të raportojë për punën e bërë kapitenit;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit detar, higjenes dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mbajë pastër vendin e punës në fund të procesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në një anije peshkimi prej druri që ndodhet në proces riparimi në zonën portuale.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve të ndryshme që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse në punë dhe nga zjarri për kryerjen e punimeve mirëmbajtëse në anijet e peshkimit me strukturë prej druri.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e punimeve mirëmbajtëse të drurit në kuvertën kryesore, në skaf, në lokale të brendshme dhe në mbiurën e komandës sipas nevojave që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- anije peshkimi prej druri në zonën portuale gjatë kryerjes së punimeve mirëmbajtëse.
 - vegla dhe instrumenta pune të disponueshme në mjetin e lundrimit prej druri.
 - repart për punime karpenterie për mjetet e lundrimit.
-

-
- udhëzues, katalogë, rregullore, standarde, manuale teknike etj.
-

2. Moduli “Punime mirëmbajtëse në anijen e peshkimit në dok”

Drejtimi: Peshkim
Profili: Peshkim
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME MIRËMBAJTËSE NË ANIJEN E PESHKIMIT NË DOK	M-16-1367-17
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer shërbime mirëmbajtëse gjatë qëndrimit të anijes së peshkimit në dok (tokë).	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II i KSHK ne drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi asiston për daljen dhe në kryerjen e punimeve të përgjithshme për dokimin e anijes së peshkimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> - të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë; - të konsultohet me kapitenin për hapat e punës së procesit apo të detyrës që i jepet; - të marrë pjesë në grup për vendosjen në vendet e caktuara të fashove për nxjerjen e anijes për dokim kur nxiret me 	

vinç;

- të marë pjesë në vendosjen e takove në vendet e përcaktuara ku do të qëndrojë anija për dokim;
- të bashkërendojë me stafin e dokimit për qëndërzimin e anijes gjatë nxjerjes për dokim;
- të marë pjesë në grup për heqjen e fashove pas pozicionimit të anijes në takot e dokut kur nxiret me vinç;
- të asistojë në grup për vendosjen dhe sigurimin e shkallës së hipje/zbritjes nga anija në dok dhe anasjelltas;
- të përdorë me teknikën e duhur stekën e lavazhit për pastrimin sa më mirë të skafit me ujë me presion nga bimësia dhe guaskat;
- të asistojë në grup për vendosjen dhe sigurimin e skelave për punime në skaf;
- të përdorë me kujdes për të mos shkaktuar dëme, rrashpën për heqjen guskave në skaf;
- të asistojë mekanikun në heqjen e sitave të prezodimareve;
- të marë masat kundra zjarrit sipas nevojës;
- të përzgjedhë me kujdes mjetet e duhura të punës;
- të raportojë saktë gjetjet dhe gjendjen tek kapiteni;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;
- të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

RN 2 Nxënësi kryen shërbime ndihmëse gjatë procesit të dokimit të anijes së peshkimit prej druri.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet te jete i afte:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të konsultohet me kapitenin për hapat e punës së procesit apo të detyrës që i jepet;
- të asistojë saldatorin/oksigjenistin në heqjen e protektorëve në pallën e timonit;
- të kepë me rrashpë dhe lyejë pallën e timonit me bojë antikorrozive dhe antivegetative;
- të pastrojë me rrashpë dhe furçe teli të elikës dhe lyejë me graso me shtresë të hollë uniformisht;
- të asistojë karpentierin në heqjen e majereve të dëmtuara;
- të asistojë karpentierin në vendosjen e majereve të reja/riparuara;
- të realizojë kontrollin e bulonave të fiksimit të majereve sipas kriterëve të kërkuara nga Kapiteni;
- të heqë me rrashpë bojën e djegur përgjatë skafit;
- të zmerilojë me zmerilatriçe majeret e drurit në skaf sipas nevojës;

- të asistojë në përgatitjen e stukos dhe shtupave të kallafatit;
- të asistojë në vendosjen e shtupave dhe stukos së kallafatit tek majeret ku ka nevojë duke përdorur veglat e takilazhit;
- të asistojë në vendosjen e fletës së bakrit në vendet ku ka nevojë;
- të kepë me rrashpë dhe lyejë me bojë shiritin metalik të piatabandës së kallumës;
- të lyejë me bojë antivegetative skafin aq duar sa i kërkohet nga Kapiteni duke përdorur furçen dhe/ose rrulin;
- të asistojë në grup për ndarjen me bojë të ndryshme në përbërje dhe ngjyrë të vijës së galexhimit të skafit;
- të lyejë me bojë të ndryshme nga ngjyra e skafit të emrit dhe numrit identifikues të anijes;
- të asistojë në grup për uljen e spirancës dhe shtrirjen e gadinës në tokë;
- të kepë me rrashpë dhe çekiç gadinat dhe spirancën nga ndryshku;
- të lyejë me bojë kundra ndryshkut dhe antivegetative dhe markojë gadinat;
- të lyejë me bojë spirancën;
- të pastrojë nga llumrat dhe lyejë me bojë pusin e gadinave në grup;
- të grasatojë me kujdes agregatet lëvizëse të vinçit të spirancës si stopuesat, muftat, burmat pa fund, fashetat shtërnguese, gjelat bllokues, etj.
- të realizojë zmontimin, pastrimin me rrashpë, lyejë me bojë dhe montojë sitat e prezodimareve;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;
- të mirëmbajë vendin e punë

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi kryen shërbime ndihmëse gjatë procesit të dokimit të anijes së peshkimit metalike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet te jete i afte:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të konsultohet me kapitenin për hapat e punës së procesit apo të detyrës që i jepet;
- të kepë me rrashpë me kujdes guaskat përgjatë skafit, në zonën e prezodimareve dhe në pallën e timonit;
- të pastrojë elikën me rrashpë dhe furçe teli me kujdes dhe t'a grasatojë atë me një shtresë të hollë grasoje të shpërndarë uniformisht;
- të asistojë specialistin në matjen e konsumit të lamjerave në skaf;

- të asistojë saldatorin në heqjen dhe vendosjen e lamjerave të konsumuara/dëmtuara;
 - të asistojë saldatorin në heqjen dhe vendosjen e protektorëve të zinkut përgjatë skafit dhe në pallën e timonit;
 - të grasatojë me një shtresë të hollë grasoje, të shpërndarë uniformisht protektorët para lyerjes me bojë të skafit;
 - të kryejë pastrimin e plotë nga grasoja të të gjithë sipërfaqes së protektorëve, para hedhjes në ujë të anijes;
 - të përgatisë bojën me komponentët përkatës sipas manualit të bojës për lyerjen e anijes;
 - të përgatisë veglat e punës sipas udhëzimit të Kapitenit;
 - të marrë njollat me bojë antikorrozive dy duar duke përdorur furçën dhe/ose rrulin;
 - të asistojë në lyrjen me bojë antikorrozive të të gjithë skafit;
 - të asistojë në dhënien e dorës së parë dhe të dytë me bojë antivegetative të skafit sipas kërkesës së Kapitenit;
 - të asistojë në mbylljen e sitave të prezodimareve;
 - të asistojë në hapjen dhe mbylljen e tapave të tankeve në skaf për pastrim;
 - të asistojë në ndarjen e vijës së galexhimit të skafit për lyerjen me bojë;
 - të lyejë me bojë emrin dhe numrin identifikues të anijes;
 - të asistojë në grup për uljen dhe shtrirjen spirancës dhe gadinës në tokë duke u siguruar më parë që nuk ka njeri që rrezikohet;
 - të kepë ndryshkun me rrashpë dhe çekiç nga gadinat dhe spiranca;
 - të lyejë me bojë dhe të markojë gadinat;
 - të lyejë me bojë spirancën;
 - të pastrojë nga llumrat dhe lyejë me bojë pusin e gadinave në grup;
 - të grasatojë me kujdes agregatet lëvizëse të vinçit të spirancës si stopuesat, muftat, burmat pa fund, fashetat shtërnguese, gjelat bllokues, etj.
 - të ngrejë me kujdes dhe në grup gadinën dhe e ri-stivosë atë në pus;
 - të sigurojë fiksimin e spirancave;
 - të sistemojë veglat e punës në vendet e tyre në depon e bashit;
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale
 - të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit
 - të mirëmbajë vendin e punës
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi asiston për hedhjen në ujë pas dokimit të anijes së peshkimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet te jete i afte:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të konsultohet me kapitenin për hapat e punës së procesit apo të detyrës që i jepet;
- të kontrollojë me kujdes mbylljen e sigurtë të tapave të tankeve;
- të kontrollojë mbylljen e sigurtë të sitave të prerezodimareve në vend;
- të kontrollojë me sy dhe dorë heqjen e plotë të grasos nga protektorët e zinkut;
- të asistojë në grup për heqjen e skelave përgjatë skafit;
- të kryejë kontroll të përgjithshëm të pjesës së nënujshme të skafit për probleme të mundshme;
- të asistojë në grup në heqjen e shkallës së hipje-zbritjes;
- të sigurojë me mjetet përkatëse fiksimin e spirancave;
- të marrë pjesë në grup për vendosjen e fashove të hedhjes së anijes në ujë pas dokimit kur hidhet me vinç;
- të bashkërendojë me stafin e dokimit për qendërzimin e anijes gjatë hedhjes në ujë pas dokimit;
- të kryejë kontrole të brendshme në skaf dhe tanke për futje uji të mundshme pas uljes jo të plotë në ujë;
- të raportojë gjendjen nga kontrollet tek Kapiteni;
- të marrë pjesë në grup për heqjen e fashove pas gjendjes së lundrueshmërisë së anijes dhe urdhërit të Kapitenit kur anija nxiret me vinç;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;
- të mirëmbajë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në një anije peshkimi prej druri dhe metalike që ndodhet në proces dokim riparimi.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve të ndryshme që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse në punë dhe nga zjarri për kryerjen e punimeve mirëmbajtëse në anijet e peshkimit si me strukturë prej druri ashtu edhe metalike gjatë procesit të dokim-riparimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e punimeve të ndryshme për kryerjen dhe gjatë procesit të dokimit siç janë nxjerja në dok, punimet e ndryshme në skaf si në anije druri ashtu edhe metalike sipas nevojave që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:

- anije peshkimi prej druri dhe metalike që do të dalin për dokim riparim dhe gjatë kryerjes së punimeve mirëmbajtëse në dokim.
 - vegla dhe instrumenta pune të disponueshme për kryerjen e punimeve të dokim riparimit të mjetit të lundrimit prej druri dhe metalik.
 - vendi ku do të kryhen punimet e dokim riparimit.
 - udhëzues, katalogë, rregullore, standarde, manuale teknike etj.
-

ⁱ Konventa e Standarteve të Trajnimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Peshkatarët e vitit 1995.

ⁱⁱ Konventa e Standarteve të Trajnimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët e vitit 1978, e ndryshuar